

VENDIM
Nr.570, datë 14.7.2010

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHETETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS FRASHËR TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shetëtore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Frashër të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shetëtore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Frashër të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.240, datë 25.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shetëtore në komunën Frashër të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Frashër për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Frashër

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
25	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
31-34	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore.	Në pronësi
35-44	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
45-48	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
49-51	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
54-63	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
64-72	Varrezat publike	Në pronësi
116-124	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
135-138	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi